

**VENDIM**  
**Nr. 904, datë 17.12.2014**

**PËR TRAJTIMIN ME KREDI TË LEHTËSUARA PËR STREHIM TË FAMILJEVE QË  
BANOJNË NË OBJEKTE TË ISH-NDËRMARRJES SHETËTËRORE, NË RRUGËN  
“SIRI KODRA”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 25, 30, 33 e 38, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Familjet, të cilat janë strehuar në objektet të ish-Ndërmarrjes Shtetërore në rrugën “Siri Kodra”, Tiranë, të cilat shpërngulen nga banesa për efekt të privatizimit të objektit nga pronari, të trajtohen me kredi të lehtësuara me interes 0%, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ministria, që mbulon fushën e strehimit, subvencionon interesin e kredisë nëpërmjet fondeve të planifikuara në projektbuxhetin afatmesëm.

3. Enti Kombëtar i Banesave të përcaktojë shumën e kredisë që përfiton çdo familje, bazuar në:

a) normat e strehimit sipas vendimit nr. 814, datë 3.12.2004, të Këshillit të Ministrave, dhe strukturën e apartamentit, që familja përfiton;

b) vlerën mesatare të shitblerjes së apartamenteve për qytetin e Tiranës, sipas udhëzimit nr. 2, datë 6.8.2014, të Këshillit të Ministrave, për koston mesatare të ndërtimit të banesave, për vitin 2014.

4. Familjet e përcaktuara në listën bashkëlidhur këtij vendimi duhet të paraqesin pranë EKB-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Certifikatë të gjendjes familjare.

b) Vërtetim negativ nga ZVRPP-ja së në emër të anëtarëve të familjes nuk figuron pronë e regjistruar.

5. Enti Kombëtar i Banesave të dërgojë në BKT listën e familjarëve, ku të përcaktohen emri, atësia, mbiemri i kryefamiljarit, struktura e apartamentit dhe vlera e kredisë që përfiton familja.

6. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**LISTA E FAMILJEVE QË TRAJTOHEN ME KREDI TË LEHTËSUARA PËR STREHIM, QË  
BANOJNË NË OBJEKTE TË ISH-NDËRMARRJES SHETËTËRORE, NË RRUGËN SIRI KODRA”  
TIRANË**

- |                     |                      |
|---------------------|----------------------|
| 1. Kanto Therçaj    | 7. Gezim Ruçi        |
| 2. Vera Hoxhaj      | 8. Kujtim Kola       |
| 3. Besnik Kopani    | 9. Petrit Ruçi       |
| 4. Lulash Nika      | 10. Kujtim Kola      |
| 5. Vladimir Davilli | 11. Vladimir Davidhi |
| 6. Destan Shehu     | 12. Riza Tabaku      |